



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK**  
**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

Drejtuar: “TRINITY TRADE COMPANY” sh.p.k. me NUIS: K81630026U

Adresa: Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative Nr.10, Rruga Alqi Boshnjaku (ish Rruga Reshit Çollaku), Ndertesa Nr.38, Hyrja 6, Ap.1, Kodi Postar 1001.

Procedura e prokurimit/lotit: “*Procedurë e hapur e thjeshtuar, mallra*”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-12631-07-09-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “*Blerje pajisje për veterinari*”, me fond limit 3,586,333 (tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “TRINITY TRADE COMPANY” sh.p.k. me NUIS: K81630026U**

Vlera e ofertës pa tvsh = 3,458,800 (tre milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.

## **2. Operatori ekonomik “ALMedical” sh.p.k. me NUIS: K21511002I**

Nuk ka paraqitur ofertë (Nuk është paraqitur Shtojca 1 dhe Shtojca 2).

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

### **Operatori ekonomik “ALMedical” sh.p.k. me NUIS: K21511002I**

#### Për arsyet e mëposhtme:

- Nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- Nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- Nuk ka paraqitur xhiron vjetore të realizuar për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar është në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.;
- Nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate;
- Nuk ka paraqitur autorizimin nga prodhuesi për pajisjet veterinare;
- Nuk ka paraqitur katalogët nga prodhuesi për pajisjet veterinare;
- Nuk ka paraqitur deklaratën lidhur me montimin dhe instalimin pranë ambienteve të caktuara nga Autoriteti Kontraktor;
- Nuk ka paraqitur deklaratën lidhur me trajnimin e stafit;
- Nuk ka paraqitur deklaratën lidhur me garancinë e mallrave objekt prokurimi jo më pak se 1(një) vit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë mirëmbajtjen e tyre pa pagesë konform specifikimeve teknike;
- Nuk ka paraqitur deklaratën se mallrat/pajisjet objekt prokurimi janë të reja dhe të papërdorura;
- Nuk ka paraqitur deklaratë se mallrat objekt prokurimi janë të certifikuara me Certifikatë Konformiteti (CE) ose ekuivalent;
- Nuk ka paraqitur asnjë dokumentë për punonjësin e kërkuar referuar kriterit 2.2.4.;
- Nuk ka paraqitur formularin e ofertës sipas Shtojcës 1;
- Nuk ka paraqitur listën e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “TRINITY TRADE COMPANY” sh.p.k. me NUIS: K81630026U me adresë Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative Nr.10, Rruga Alqi Boshnjaku (ish Rruga Reshit Çollaku), Ndertesa Nr.38, Hyrja 6, Ap.1, Kodi Postar 1001, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,458,800 (tre milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**